



Nr. 135 Prot.

Tiranë, 26 nëntor 2018

Njoftim

Për punësimin e një shoferi pranë Universitetit Katolik ZKM, selia e Elbasanit

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" kërkon të punësojë një shofer për selinë e Elbasanit. Kohëzgjatja e kontratës do të jetë një vit, me kalimin e një periudhe prove prej tre muajsh. Angazhimi i punës është 30 orë në javë, duke filluar brenda muajit dhjetor 2018.

Kandidatët e interesuar duhet të zotërojnë:

1. njohje të mirë të gjuhës italiane;
2. aftësi të mira komunikimi, aftësi praktike, besueshmëri, sjellje të edukuar;
3. aftësi të mira për të punuar në grup;
4. aftësi të mira në drejtimin e makinës;
5. eksperiencë në drejtimin e makinës.

Në kushtet e një vlerësimi të barabartë, ka prioritet kandidati që banon në Elbasan apo në zonat përreth.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë në zarf të mbyllur pranë sekretarisë didaktike të selisë së Elbasanit, brenda **datës 10 dhjetor 2018, ora 17.00** dokumentacionin e poshtëshënuar:

1. Kërkesë me shkrim drejtuar Administratorit të Universitetit (në gjuhën italiane);
2. Curriculum Vitae (në gjuhën italiane) me firmë;
3. Fotokopje të titullit të studimit dhe të listës së notave;
4. Fotokopje të një dokumenti identifikimi të vlefshëm në momentin e aplikimit;
5. Fotokopje të patentës.

Mbi zarfin e dokumenteve të kërkuara duhet të shënohen: emri, mbiemri, adresa e banesës, numri i telefonit, adresa elektronike e kandidatit dhe pozicioni i punës për të cilin aplikon kandidati.

Administratore

Znj. **Evis Karandrea**

